



## **Putini, Vuçiqi dhe Maduro: Boshti i Diktaturës dhe Pasojat për Venezuelën dhe Ballkanin**

*Boshtet e diktaturës vazhdojnë të shfaqen si një hije e zezë mbi botën demokratike. Symbyllja para këtyre akteve forcon këto diktatura duke i bërë kërcënim serioz për mbarë botën. Serbia si një nga kontribuuesit kryesorë të kësaj, është duke u bërë teli i bombës së Kremlinit për të shpërthyer brenda Perëndimit.*

**Shkruan: Agim Musliu – Drejtor në Institutin për Studime të Luftës Hibride “OCTOPUS”**

Nicolas Maduro fitoi zgjedhjet në Venezuelë, dhe menjëherë pas shpalljes së rezultateve, Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin ishte ndër të parët që e uroi. Pas tij, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq gjithashtu uroi diktatorin Maduro për fitoren e tij të diskutueshme.

Gjatë udhëheqjes së Nicolas Maduro, vajzat e reja detyroheshin të kryenin prostitucion për të siguruar ushqim. Një vend shumë i pasur me burime natyrore është reduktuar në varfëri ekstreme, më keq se disa vende afrikane. Aktualisht, 94% e popullsisë së Venezuelës jeton në varfëri, ndërsa 74% janë në varfëri ekstreme, me pamundësinë e furnizimit të rregullt me ushqim. [Burime të tjera: 82% / 53%]. Rreth 300,000 gra venezuelase, gjatë sundimit të Nicolas Maduro janë detyruar të punojnë si prostituta në kufirin me Kolumbinë për të siguruar ushqim për veten dhe familjet e tyre. Kolumbia, ndonëse gjithashtu një vend i varfër, është më pak i varfër se sa Venezuela.

Nëpërmjet luftës hibride, Rusia e shtyri Venezuelën në mënyrë strategjike drejt izolimit duke e mbështetur atje diktaturën politike e cila pas fitores së Maduros do të vazhdojë ende. Arsyeja



kryesore pse Venezuela kontrollohet nga Rusia dhe mbetet e izoluar, me një rend politikanësh të korruptuar, është për të siguruar që ky vend, edhe pse shumë i pasur me naftë, të mos jetë në tregun ndërkombëtar të naftës. Kjo i lejon Ruisë të shesë naftë një vendi që ka burime të shumta të këtij lëngu të çmuar, duke përfituar ekonomikisht nga situata e diktaturës e Venezuelës.

Kjo qeveri e Venezuelës, kaq e pabesë që kontrollon dhe vjedh pasurinë për një grusht njerëzish i ofron edhe një pozitë strategjike si aleat Ruisë në Amerikën Latine duke treguar se autokracitë dhe diktaturat moderne të sponsorizuara nga Rusia janë edhe më të këqija se nazizmi i Hitlerit.

Situatën e njëjtë e dëshiron Putini edhe në Ballkan dhe që është synon këtë strategji ta shtyjë me çdo kusht nëpërmjet proxyt të saj Serbisë dhe vartësit të tij Aleksandër Vuçiqit. Shkatërrimi i demokracisë, ndalja e rrugëtimit për në BE, sabotimi i NATO-së, kontrolli i resurseve humane dhe kapitale, pozicionimi strategjik dhe heqja qafe e etnive që i konsiderojnë armiqësore si shqiptarët.

Çuditërisht interesi i litiumit po e fuqizon strategjinë e Ruisë dhe Serbisë dhe këtë alarm, perëndimi po e neglizhon aq sa mund të bëhet vonë reagimi sikur për Hitlerin në Luftën e Dytë Botërore.

Urimi i Vuçiqit për “fitoren” e Maduros si duket tek perëndimoret do kalojë prap pa vëmendjen e duhur?

Vuçiqi nuk merr mundin kot të uroj askënd, andaj urimi i tij për fitoren e Maduros tërheq edhe një herë vëmendjen fuqishëm mbi përfshirjen strategjike të Serbisë në planet Euro-Aziatike të Kremlinit dhe kontributin thelbësor të Vuçiqit në zbatimin e këtyre planeve.

Si është e mundur që perëndimi të lejoj kaq hapur Serbinë të sabotojë demokracinë në nivel global, të sabotojë strategjinë e sigurisë së perëndimit, të kontribuojë në planet e Kremlinit dhe të vazhdojë të shfaqet si një kërcënim serioz për Ballkanin Perëndimor?

Kësaj pyetje mundet që askush në BE nuk ia di përgjigjen ose e neglizhojnë nga shkurtpamësia e interesave të agjendave zhvillimore të krijuara kushedi para sa viteve që nuk janë rifreskuar për të iu përgjigjur kërcënimeve të kohës.



Duhet të kujtojmë se me të njëjtin ritëm si në Venezuelë, edhe Vuçiqi me grupin e tij manipuloi zgjedhjet në Serbi dhe përkundër vërejtjeve nga raportet ndërkombëtare si të OSBE-ODIHR dhe organizatave tjera, perëndimi mbylli njëri sy dhe i pranoi këto zgjedhje si legjitime.

Bashkëpunimi me Vuçiqin është i njëjtë sikur me Putinin, madje as klonimi i këtyre të dyve nuk do bënte afërsi më të madhe politike e strategjike.

NATO dhe BE-ja duhet seriozisht të rishikojnë format e tyre të bashkëpunimit me Serbinë para se të jetë shumë vonë. Ruajtja e demokracisë, lirisë dhe zhvillimit njerëzor sot nuk është më çështje e izoluar, por një çështje e hapur e influencave globale.

(CC BY-NC 4.0) Ky artikull është i licencuar për ju nën një Licencë Ndërkombëtare Creative Commons Attribution 4.0. Kur ta kopjoni dhe ta rishpërndani këtë punim të plotë ose pjesërisht, ju duhet t'i jepni meritat e duhura për ta siguruar që të tjerët mund ta gjejnë më vonë këtë punim (dhe për të siguruar që të tjerët të mos ju akuzojnë për plagjiaturë).